

## Kastrioti/ Drejtuesit i vene "ultimatum" lojtareve

nga AlbaniaSoccer

E mërkurë, 02 Tetor 2013 11:08

---



Ekipi i Kastriotit, pas humbjes me Kukësin në fundjavë sot luan takimin e radhës në kampionat me Tiranën. Mesohet nga burime pranë klubit krutë, se lojtarëve u është vënë kusht fitorja ndaj Tiranës për lekuidimin e rrogave.

Gjithashtu do të ketë dhe shpërblime për lojtarët e Kastriotit. Ndoshta kjo mund të jetë një strategji për të motivuar me shumë lojtarët përpara takimit me Tiranën. Nëse Kastrioti do të arrijë të sigurojë rezultat pozitiv do të shmangte kështu zonën e ftohtë të tabelës.